

VENDIM
Nr.138, datë 7.12.2011

**PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË KESH SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të investimeve të KESH sh.a. për periudhën e tretë rregullatore,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë KESH sh.a. për planin e investimeve për periudhën e tretë rregullatore, në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e KESH sh.a., për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani